



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1040 Prot.

Tiranë, më 02.08 2017

VENDIM Nr. 159, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, datë 26.07.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Gërmimit arkeologjik të shpëtimit në zonën e përcaktuar si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Korçë - Turan KM 40 +600, "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*" - subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Gërmimit arkeologjik të shpëtimit në zonën e përcaktuar si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Korçë - Turan KM 40 +600, "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*" -subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të vijojë Gërmimi arkeologjik i shpëtimit në zonën jashtë kanalit të tubacionit të Linjës së gazsjellësit TAP, me qëllim identifikimin e sipërfaqes totale të varrezës të vendbanimit jetëgjatë, në këtë zonë, në vijim të akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "SPIECAPAG Shqipëria", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k dhe ASHA.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETARI KKA  
RUDINA ZOTO